

VENDIM
Nr.60, datë 19.8.2009

**PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTEVE PRODHUESE (PARKU EOLIK MASKURI) TË
SHOQËRISË “RUNNING ENERGY” SI BURIME TË RINOVUESHME ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të çertifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 9, pika 1 dhe pika 2, germa “a”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 19.8.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhuese (parku eolik Maskuri) si burime të rinovueshme energjie

konstatoi se:

- Me vendimin nr.48, datë 6.7.2009, Bordi i Komisionerëve ka filluar procedurat e shqyrtimit të aplikimit të shoqërisë “RUNNING ENERGY” për kualifikimin e impianteve prodhues (Parku eolik Maskuri) si burime të rinovueshme energjie.

- Dokumentacioni bashkëlidhur aplikimit është në përputhje me kërkesat e neneve 6 dhe 7, pikat 1, 2 dhe 3 të rregullores së procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e impiantit prodhues (Parku eolik Maskuri) të shoqërisë “RUNNING ENERGY” si burime të rinovueshme energjie.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta